Vlerësime gjithëpërfshirëse

Nevojat dhe pikat e forta të fëmijëve dhe adoleshentëve

dhe Sistemi i vlerësimit të koordinuar

Gjithçka ka të bëjë me ju

Ju jeni në qendër të procesit të vlerësimit

Nevojat dhe pikat e forta të fëmijëve dhe adoleshentëve (CANS) dhe Sistemi i vlerësimit të koordinuar (CAS)

CANS dhe CAS janë vlerësime që mbledhin informacione në lidhje me pikat tuaja të forta, nevojat dhe interesat për të ndihmuar menaxherin tuaj të kujdesit që të krijojë një plan shërbimesh dhe mbështetjesh që është i duhuri për ju. CANS është krijuar për fëmijë dhe të rinj (deri në moshën 17 vjeç), ndërsa CAS është për të rriturit (mosha 18 vjeç e më lart). Si CANS ashtu edhe CAS sigurojnë që personi që merr shërbime të jetë në qendër të procesit të planifikimit.

Si funksionojnë CANS dhe CAS?

Një vlerësues i trajnuar do të flasë me ju dhe njerëzit e tjerë që zgjidhni të cilët ju njohin më mirë për sa i përket jetës suaj: interesat tuaja, aftësitë e jetesës, shëndetin dhe sistemet ekzistuese të mbështetjes. Biseda përqendrohet rreth jush, por mund të përfshijë të dhëna nga të tjerët që ju njohin mirë, si një person në rrethin tuaj të mbështetjes, pjesëtarët e familjes, miqtë dhe/ose njerëzit që tashmë ju ofrojnë mbështetje. Vlerësuesi do të shikojë gjithashtu informacionin tuaj të kaluar për t'u siguruar që ata kanë përfshirë gjithçka që nevojitet për të plotësuar CANS ose CAS, në varësi të moshës suaj. Ky informacion do të jetë në dispozicion të menaxherit tuaj të kujdesit, i cili do t'ju informojë në lidhje me këtë.

Si do të më ndihmojë CANS ose CAS për të marrë shërbimet e duhura?

Informacioni që jepni gjatë vlerësimit do të ndihmojë menaxherin tuaj të kujdesit që të zhvillojë një plan të jetës që do të informojë se cilat mbështetje janë të përshtatshme për ju. Është e rëndësishme që ju, familja juaj dhe stafi ndihmës të përshkruani atë që dëshironi dhe keni nevojë në mënyrë që ofruesi juaj i shërbimit të mund të ofrojë mbështetje dhe shërbime cilësore për ju dhe familjen tuaj.

Nëse tashmë jam duke i marrë shërbime, a duhet të bëhet një vlerësim?

Gjithkush që merr shërbime nga zyra e OPWDD-së (Zyra për Personat me Aftësi të Kufizuara Zhvillimore) do të ketë nevojë që të plotësojë një CANS ose CAS. Informacioni nga vlerësimi do të përdoret për t'u siguruar që shërbimet tuaja përputhen me nevojat dhe interesat tuaja.

Si mund të filloj?

Vlerësuesi do t'ju telefonojë për të planifikuar një diskutim dhe do t'i kërkojë menaxherit tuaj të kujdesit të sigurohet që dikush tjetër që ju dëshironi në diskutim, si pjesëtarët e familjes, të përfshihet në diskutim. Nëse jeni i sapoardhur dhe nuk keni një menaxher kujdesi, vlerësuesi do të punojë me ju dhe njerëzit që ju mbështesin për t'u siguruar që të gjithë njerëzit e duhur të intervistohen.

Si mund të jem i sigurt që CANS ose CAS do të funksionojë për mua?

CANS dhe CAS janë testuar dhe vërtetuar për t'u përdorur te njerëz me aftësi të kufizuar intelektuale dhe/ose zhvillimore. CANS është krijuar posaçërisht për fëmijët dhe të rinjtë, ndërsa CAS është shkruar që të jetë i përshtatshëm për të rriturit.

Po në lidhje me vlerësimet e tjera që kërkohen nga Zyra OPWDD?

Juve mund t'ju kërkohet gjithashtu të bëni vlerësime të llojeve të ndryshme. Disa kërkohen sipas ligjit dhe rregullores, dhe disa të tjera janë mjete shtesë për planifikimin e shërbimeve të përdorura nga menaxherët e kujdesit. Të gjitha ofrojnë informacion kritik për të siguruar që shërbimet do të plotësojnë nevojat e secilit person. Disa nga vlerësimet që mund të hasni janë:

Profili i personave me aftësi të kufizuara zhvillimore - 2 (DDP-2)	I nevojshëm	Përdoret si vlerësim funksional i nevojave, që në të ardhmen do të zëvendësohet nga CANS dhe CAS
CAS/CANS	I nevojshëm	Përdoret si vlerësim funksional i nevojave, që do të zëvendësojë DDP-2 në të ardhmen
IAM (Vlerësimi 'Gjithçka ka të bëjë me mua") ose mjete të tjera	Opsionale	Përdoret në planifikimin e përqendruar te personi si mjet për të përgatitur një plan jete;

CCO-së (Organizatës së Koordinimit të Kujdesit)		Menaxherët e kujdesit mund të përdorin IAM ose një mjet tjetër të planifikimit
Vlerësime të funksionimit përshtatës, vlerësime psikosociale dhe të tjera specifike për disiplinat klinike dhe/ose shërbimet e kërkuara	Të nevojshme, por varet nga shërbimet që kërkohen ose marrin	Përdoret për të demonstruar të drejtën për shërbimet e OPWDD-së

Çfarë ndodh pas vlerësimit CANS/CAS?

Menaxheri juaj i kujdesit do t'ju informojë mbi raportin e CANS ose përmbledhjen e CAS dhe do të takohet me ju për të diskutuar në lidhje me të.

Çfarëdo që ju dhe/ose njerëzit që ju mbështesin thoni që është e rëndësishme, do të mbahet shënim, dhe ky informacion do të përdoret për të ndihmuar zhvillimin e planit tuaj të jetës ose përditësimin e dokumentacionit tjetër, sipas nevojës.

Nëse ju dhe/ose njerëzit që ju mbështesin keni ndonjë pyetje rreth informacionit në raportin

tuaj të CANS ose përmbledhjen e CAS:

• Pyesni menaxherin tuaj të kujdesit. Menaxheri juaj i kujdesit mund të përgjigjet për pyetjet në lidhje me raportin ose përmbledhjen.

• Nëse menaxheri juaj i kujdesit nuk mund t'u përgjigjet pyetjeve tuaja, ose nëse keni ndonjë shqetësim, ai/ajo mund t'ia përcjellë ato pyetje zyrës së OPWDD-së.

• OPWDD-ja do të kontaktojë me menaxherin tuaj të kujdesit për të folur ose përgjigjur pyetjeve dhe/ose shqetësimeve tuaja,

OSE

• Ju mund të telefononi direkt zyrën e OPWDD-së në nr. (518) 473-7484 dhe të lini emrin tuaj, emrin e personit që u vlerësua, ID-në e tyre të TABS (nëse dihet) dhe një numër telefoni kontakti.

• Një anëtar i ekipit të OPWDD-së për CANS/CAS do t'ju marrë në telefon dhe do t'ju ndihmojë që t'i përgjigjet pyetjeve që keni.